



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Prot 47/22

Tiranë, më 29/08/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT ALFRED ELEZI

Nr. 39, datë 29.08.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Enton Radovani	Kryesues
Kleada Mersinllari	Relatore
Edona Dushaj	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ledjana Azemaj, në datën 29.08.2024 ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Alfred Ismail Elezaj**, me funksion Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,




pasi dëgjoi relatimin e relatores së çështjes Kleada Mersinllari; dëgjoi subjektin e vlerësimit, Alfred Ismail Elezi i cili në seancën dëgjimore publike të datës 25.07.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në terësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, shtetasi z. Alfred Elezi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit datë 04.07.2023, me pozicionin “Zëvendës drejtorit për Sigurinë dhe Policimin, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë.” Ndërsa e urdhërin nr. *** datë 25.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mban funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
3. Subjekti i vlerësimit **z. Alfred Elezi**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga trupat e vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr.1 datë 24.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: znj. Kleada Mersinllari **Relatore**, z. Enton Radovani **Kryesues** dhe znj. Edona Dushaj, **Anëtare**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr.1 datë 24.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alfred Ismail Elezi.
6. Relatori i çështjes, znj. Kleada Mersinllari nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 25.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e

njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. *** Prot. datë 28.07.2023 duke shprehur nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12.2018 i ndryshuar relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** Prot, datë 25.07.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr. *** Prot, datë 27.07.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale
 - c. me shkresën nr. *** Prot, datë 25.07.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP-ë deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 -  Vlerësimin e pasurisë;
 -  Kontrollin e figurës;
 -  Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - d. Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - e. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
 - g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”;

h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme, dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:

✚ *Deklarata e Pasurisë;*

✚ *Deklarata për Kontrollin e Figurës;*

✚ *Formulari i Vlerësimit Profesional;*

✚ *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.*

i. Raportet përmbledhëse të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;

k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;

l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, në datën 16.07.2024, pasi dëgjoji relatorin, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë dhe konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi, me Vendimin nr. 2 datë 16.07.2024, vendosi:

a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi.

b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 7 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Në hetimin administrativ u përfshinë edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, të ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Më datë 23.07.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 25.07.2024, në orën 12:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 25.07.2023, subjekti i vlerësimi z. Alfred Elezi kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 29.08.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Alfred Elezi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Alfred Elezi, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën (09.03.2023), brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 4 index, viti 2023.

18. Procedurat e deklarinimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin

e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja.

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z.Alfred Elezi, ku është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimit financiar të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.**

A/1. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

¹ Raporti nr. *****, datë 21.03.2024, i ILDKPKI-së.

24. Bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë degjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

- ❖ Apartament banimi me sipërfaqe të banuar 112.5 m² dhe sip. totale 131.8 m² (bashkuar nga dy apartamente banimi në një, përkatësisht, njëri apartament me sip. 62.8 m² dhe tjetri me sip. 49.7 m²), blerë me anë të kontratë së shitjes nr. *** rep., nr. 1183 ***, datë 18.09.2008, nga shoqëria “Ilad shpk”, në vlerën 38.250 euro, por paguar në fakt nga babai i bashkëshortes Lufti Meçka, sipas kontratës së porosisë nr. **** rep., nr. *** kol., datë 21.01.2008, në vlerën 59.310 euro dhe 5.690 euro, punime shtesë e arredim të kryer nga unë dhe bashkëshortja. **Vlera** 65.000 euro. **Pjesë takuese** 100% me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** shuma prej 5.690 euro është siguruar nga të ardhurat e mia dhe bashkëshortes gjatë periudhës 2001 - 2009, ndërsa, shuma 59.310 euro është dhuratë nga prindërit e bashkëshortes, sipas akt dhurimit datë 25.01.2008, i formalizuar me aktin noterial të dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.04.2018, (e bërë lapsus nga noterja shuma prej 59.300 euro).
- ✚ Vlera është transferuar nga llogaria e L. Meçka në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “Ilad” shpk, vërtetuar kjo me anë të transfertës datë 25.01.2008. Për shlyerjen e vlerës totale për blerjen e 3 apartamenteve është marrë kredi nga prindërit e bashkëshortes, në shumën 12.000.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës.

- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 22.10.2008, të pasurisë apartament, me sip. 62.8 m², regjistruar me nr. ****, ZK. **, në bashkëpronësi të Alfred Elezi, Julinda Elezi, ndodhur në Mëzez, Tiranë.

- **Bashkëlidhur:** Kartela e pasurisë, regjistruar në datë 22.10.2008, në emër të Alfred Elezi dhe Julinda Elezi, paguar në vlerën 21.352 euro.
- Certifikata për vërtetim pronësie datë 05.02.2008, të pasurisë apartament, me sip. 62.8 m², regjistruar me nr. ****, ZK. ****, në pronësi të “Iliad” shpk.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 22.10.2008, të pasurisë apartament, me sip. 49.7 m², regjistruar me nr. *****, ZK ****, në bashkëpronësi të Alfred Elezaj, Julinda Elezaj, ndodhur në Mëzez, Tiranë.
- **Bashkëlidhur:** Kartela e pasurisë, regjistruar në datë 22.10.2008, në emër të Alfred Elezi dhe Julinda Elezi, paguar në vlerën 16.898 euro.
- Certifikata për vërtetim pronësie datë 05.02.2008, të pasurisë apartament, me sip. 49.7 m², regjistruar me nr. *****, ZK. ****, në pronësi të “Iliad” shpk.
- Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, nr. **** rep., nr. **** kol., datë 18.09.2008, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria “Iliad” shpk dhe palës blerëse Alfred Elezaj dhe Julinda Elezaj, të apartamenteve me sip. 62.8 1712, regjistruar me nr. *****, ZK **** dhe me sip. 49.7 m², regjistruar me nr. *****, ZK. ****. Çmimi i shitblerjes është 340 euro/m², në total 38.250 euro.

✚ Sot, me nënshkrimin e kësaj kontrate, pagesa është shlyer plotësisht nga blerësi tek shitësi, në shumën e plotë të vlerës së apartamentit, jashtë zyrës noteriale.

- Kontratë sipërmarrje, nr. **** rep., nr. ** kol., datë 21.1.2008, nënshkruar ndërmjet palës sipërmarrëse shoqëria “Iliad” shpk dhe palës blerëse L. Meçka, të apartamenteve: nr. **, me sip. 67.4 m²; nr. **, me sip. 74.8 m²; nr. **, me sip. 57 m². Çmimi i shitblerjes është 450 euro/m², në total 89.640 euro, do të likuidohet brenda njëjave nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Mandat transferte bankare, datë 25.01.2008, në Raiffeisen Bank, Lutfi Meçka transferon shumën 89.640 euro në favor “Iliad” shpk, me përshtkrimin “konvertim”
- Akt dhurimi datë 25.01.2008, i shtetasve L. Meçka dhe R. Meçka, të cilët deklarojnë se i dhurojnë vajzës së tyre, Julinda Elezaj, shumën prej 59.310 euro, për blerje banese tek shoqëria “Iliad” shpk, në Mëzez, Tiranë, sipas kontratës së bërë nga ai dhe bashkëshortja në shoqërinë “Iliad”, për blerjen e 3 apartamenteve 1+1. Nga këto banesa, dy prej tyre i kanë porositur për vajzën e tyre dhe bashkëshortin e saj.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.04.2018, e shtetasve L. Meçka dhe R. Meçka, të cilët deklarojnë se, në datën 25.01.2008 i kanë dhuruar vajzës së tyre Julinda Elezi (Meçka) shumën prej 59.300 euro, sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.01.2008. Vlera e dhuruar është ndihmë ekonomike e siguruar prej tyre nëpërmjet kredisë së akorduar nga RFZ Bank në shumën 12.000.000 lekë.
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. ** kol., datë 17.01.2008, nënshkruar ndërmjet palës kredidhënëse Raiffeisen Bank dhe palës kredimarrëse L. Meçka dhe R. Meçka, të shumës 12.000.000 lekë, me qëllim përdorimin për “Housing”. Afati i shlyerjes 190 muaj. Hipotekuesi për të garantuar shlyerjen e plotë të detyrimeve të kësaj kredie bankare, krijon hipotekë mbi pasuritë: Truall + ndërtesë, me nr. pasurie *****, me sip. 310 m², ndodhur në Lagja nr. **, Kukës;
- Apartament me nr. *****, me sip. 58 m², ndodhur në Lagja nr. **, Kukës.

- ✚ **ASHK, Drejtoritë Vendore Tiranë Veri, Kamëz Vorë, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ Në deklaratën “Para Fillimit të Detyrës 2011”, subjekti deklaroi shtëpi banimi me sip. 131 m², në Fushë Mëzez Kashar, e blerë në vitin 2008, vlerë 65.000 euro. **Burimi i krijimit:** nga të ardhurat dhe kursimet familjare në vite dhe marrë kredi nga NBG Bank, vlerë 89.000 euro.
- ✚ **Me process-verbalin e datës 04.01.2024.** subjekti paraqiti sqarimet e tij lidhur me pasurinë e mësipërme. Sqaroi se, kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.01.2008, e lidhur ndërmjet “Ilad” shpk dhe L. Meçka, është bërë për tre apartamente me sip. prej 67.4 m², 74.8 m² dhe 57 m², në total 199.2 m² Çmimi total i tre apartamenteve ka qenë 89.640 euro. Fakti i kryerjes së pagesës vërtetohet me anë të transfertës bankare nga llogaria e L. Meçka, datë 25.01.2008, në shumën 10.971.936 lekë, konvertuar me kursin e ditës, nga **vlera 89.640 euro**. Si palë përfituese, ai dhe bashkëshortja, nuk kanë treguar interes lidhur me çmimin e vendosur në kontratë për shkak se ishin përfitues me anë të dhurimit dhe vlera për ta ishte e parëndësishme. Fakti i kryerjes së pagesës i është konfirmuar nga vjehri, L. Meçka, dhe për këtë shkak nuk janë interesuar sa ishte vlera në kontratën e shitjes. Në këtë transkasion, nuk ishin palë paguese duke qenë se shuma ishte paguar kohë më parë. Dhurimi provohet pasi L. Meçka dhe R. Meçka kanë bërë një deklaratë me shkrim se i dhurojnë vajzës së tyre dhe vetë subjektit, dy apartamente nga tre që kishin porositur, të cilat kishin vlerën 59.310 euro (131.8 m² x 450 euro/m²). Deklarata është noterizuar në datë 25.04.2018. Nuk ka patur asnjë kontratë anulimi të kontratës së porosisë së nënshkruar nga L. Meçka. Bashkimi i dy apartamenteve është kryer nga vetë firma “Ilad” shpk dhe në kohën e përpilimit të kontratës së shitjes, ishte kryer edhe bashkimi i tyre. Përsa i përket mobilimit, sqaroi se, investimi është kryer gjatë viteve 2008 - 2009 dhe kanë shpenzuar gjithsej 5.690 euro, të siguruara nga kursimet ndër vite nga puna e tij dhe bashkëshortes, përgjatë viteve 2001 - 2009. Për shkak të angazhimeve të punës, kontrata e furnizimit me energji elektrike ka ngelur në emër të L. Meçka, ndërsa, kontrata e furnizimit me ujë është në emër të tij.
- Lidhur me deklarimin e kyjer në “Deklaratën Para Fillimit të Detyrës 2011”, sqaroi se ka qenë një lapsus në formulimin e saj pasi është e vërtetë që disponon një banesë në Fushë Mëzes, me sip. 131 m² (së bashku me sipërfaqet e përbashkëta), por, sic e ka deklaruar dhe provuar, i është dhuruar nga vjehri L. Meçka. Blerja e banesës është kryer sipas kontratës së porosisë me nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.01.2008. Paga është kryer po prej tij, sipas një kredie të marrë në RFZ Bank, për të cilën ka paraqitur dokumentacion. **Paraqiti:**
 - Nxjerrje llogarie në emër të L. Meçka pranë RFZ Bank, në të cilën, në datën 25.01.2008, evidentohet kreditimi i kredisë me vlerë 12.000.000 lekë si dhe transferimi i shumës 10.971.936 lekë, në favor të “Iliad” shpk.
- ✚ Me inventarin e datës 18.03.2024 subjekti **paraqiti:**
 - Deklaratë, datë 13.03.2024, e administratorit të shoqërisë “Iliad” shpk, I. Shameti, i cili deklaroi se shtetasit Alfred Elezaj dhe Julinda Elezaj, me kontratën nr. **** rep. nr. *** kol., datë 18.09.2008, kanë përfituar në pronësi apartamentet nr. **, regjistruar me nr. ****, ZK. **** dhe

nr. **, regjistruar me nr. *****, të ndodhura në Komunën Kashar, Mëzes, Tiranë, të cilat kanë qenë fillimisht të regjistruara në emër të shoqërisë ndërtuese. Çmimi për këto apartamente është paguar tërësisht nga L. Meçka në llogarinë bankare të shoqërisë, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.01.2008, i cili ka porositur apartamentet nr. **, **, **, të llogaritura me sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe sip. të përbashkët. Shtetasi L. Meçka ka deklaruar se apartamentet nr. ** e ** po i blinte për vajzën e tij, Julinda Elezaj, dhe ka kërkuar që kur të bëhej kontrata përfundimtare, këto apartamente t'i kalonin familjes së saj. Pasi janë konsultuar me noteren F. M dhe kanë depozituar të gjithë dokumentacionin që kishin në disponim, ajo i ka orientuar duke bërë kontratën e kalimit të pronësisë nga shoqëria “Iliad” shpk, te familja Alfred dhe Julinda Elezaj.

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 13.03.2024, e shtetasve L. Meçka dhe R. Meçka, të cilët deklarojnë se banesat e blera sipas kontratë shitblerje me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 18.09.2008, me shitës shoqëria “Iliad” shpk dhe blerës Alfred e Julinda Elezaj, i janë dhuruar nga ana e tyre. Vera prej 59.300 euro është dhënë prej L. Meçka, jashtë zyrës noteriale, provuar kjo sipas mandat pagesës datë 25.01.2008, nga RFZ Bank, kaluar në llogarinë e shoqërisë “Iliad” shpk., në Alpha Bank, sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.01.2008. Në kontratën përfundimtare të shitblerjes, nuk është përfshirë sip. e përbashkët dhe vlera ka qenë 450 euro për m².
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 22.10.2008, pasuria apartament, me sip. 58.8 m², regjistruar me nr. *****, në emër të L. Meçka e R. Meçka. Bashkëlidhur, kartela e pasurisë, sipas së cilës, shumat e paguar për këtë pasuri është 19.992 euro.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.06.2020, palë shitëse L. Meçka dhe R. Meçka, palë blerëse V. C, të apartamentit me sip. 58 m² ndodhur në Mëzez, regjistruar me nr. *****, ZK. **** Çmimi i shitjes 20.000 euro do të paguhet në Credins Bank.

✚ Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPK në mënyrë të përmbledhurt rezulton se:

- ✓ Pasuria apartament, me sip. totale neto prej 112.5 m² është porositur fillimisht nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, me anë të një kontrate porosie, datë 21.01.2008, në vlerën totale prej 89.640 euro, shumë e cila përmban vlerën e tre apartamenteve të shitura, dy prej të cilave janë objekt i pasurisë së mësipërme.
- ✓ Po në këtë datë, prindërit e bashkëshortes nënshkruajnë një akt dhurimi për dy prej apartamenteve të blera, të cilat ja kalojnë vajzës së tyre. Pë blerjen e tre apartamenteve ka shërbyer kredia bankare në RFZ Bank, me vlerë 12.000.000 lekë, përfituar gjithashtu nga babai i bashkëshortes, duke kryer kështu në datë 25.01.2008 edhe likuidimin total me transfertë bankare të kontratës së porosisë me vlerë 89.640 euro.
- ✓ Në datën 18.09.2008, subjekti dhe bashkëshortja nënshkruajnë kontratën e shitblerjes së dy apartamenteve. Apartamenti tjetër u përfitua nga prindërit e bashkëshortes (konfirmuar nga dokumentacioni i paraqitur), të cilët e kanë shitur në vitin 2020.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.
- ✓ Deklarohen shpenzime mobilimi për artamentin në shumën prej 5.690 euro konvertuar gjithësej në 650.000 lekë.

Pasuria nr. 2

- ❖ Automjet Renault Tëingo, me targë *****, në emër të bashkëshortes Julinda Elezi (Elezaj), me vlerë 250.000 lekë, blerë në vitin 2007 dhe shitur 100.000 lekë në vitin 2015. **Pjesë takuese** 100% me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe kursimet e bashkëshortes nga viti 2001 deri në 2007.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 26.06.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. M dhe palës blerëse Julinda Elezi, të automjetit Renault Tëingo. Çmimi i shitjes 250.000 lekë.
- Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. *** kol., datë 06.06.2015, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Julinda Elezi dhe palës blerëse O. S, të automjetit Renault Tëingo. Çmimi i shitjes 100.000 lekë.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. ***, datë 18.08.2023, nuk e konfirmon automjetin në pronësi të Julinda Elezi.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. ***, datë 20.12.2023, ka bashkëlidhur dokumentacionin ligjor të automjetit me targë *****, në pronësi të Julinda Elezi:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 26.06.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. M dhe palës blerëse Julinda Elezi, të automjetit Renault Tëingo. Çmimi i shitjes 250.000 lekë.
- Kontratë blerje e automjetit Renault Tëingo, në shtetin gjerman, nga A. M, datë 03.05.2007, vlerë 700 euro.

✚ Në deklaratën Para Fillimit të Detyrës 2011, subjekti deklaroi automjet Renault Tëingo, blerë rreth vitit 2007, në vlerën 400.000 lekë.

✚ **Me inventarin e datës 18.03.2024**, subjekti sqaroi se vlera e deklaruar 400.000 lekë, ka qenë një lapsus gjatë plotësimit të deklaratës.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR. Automjeti është shitur.

Pasuria nr. 3

- ❖ Automjet Ford Fiesta, me targë ***** (i dëmtuar pjesërisht në momentin e blerjes), në emër të bashkëshortes Julinda Elezi, e blerë në vitin 2014, në shumën 100.000 lekë, datë 11.04.2014, e shitur në vlerën 4.000 euro, datë 10.12.2018. **Pjesë takuese** 100% me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** të ardhurat nga pagat e mia të vitit 2014, kursimet e bashkëshortes, si dhe 350.000 lekë (202.404

lekë për pagesën e doganës e diferenca për lyerjen e automjetit) dhuratë nga prindërit e bashkëshortes L. Meçka e R. Meçka

Bashkëlidhur deklaratës.

- Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 11.04.2014, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E. Balla dhe palës blerëse Julinda Elezi, të automjetit Ford Fiesta. Çmimi i shitjes 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 10.12.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Julinda Elezi dhe palës blerëse F. L, të automjetit Ford Fiesta, me targë ****. Çmimi i shitjes 4.000 euro.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. **, datë 18.08.2023, konfirmon se, shtetasja Julinda Elezi ka patur të regjistruar në emër të saj automjetin me targë *****. Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 10.12.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Julinda Elezi dhe palës blerëse F. L, të automjetit Ford Fiesta, me targë ****. Çmimi i shitjes 4.000 euro.
- Kontratë shitblerje automjeti nr. ** rep., nr. **** kol., datë 11.04.2014, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E. B dhe palës blerëse Julinda Elezi, të automjetit Ford Fiesta. Çmimi i shitjes 100.000 lekë.
- Dokumentacioni ligjor i automjetit, regjistruar në emër të Julinda Elezi.

➤ **Me proces - verbalin e datës 04.01.2024** subjekti paraqiti sqarimet e tij lidhur me automjetin, i cili është blerë në datë 11.04.2014, me anë të kontratës së shitjes nr. ** rep., nr. ** kol., në gjendje të aksidentuar për vlerën 100.000 lekë. Mjeti në momentin e blerjes ka patur targa të huaja, përkatësisht italiane dhe pa doganë të paguar. Në mënyrë që ky mjet të bëhej në gjendje pune është shpenzuar për riparime në servis shuma rreth 150.000 lekë, vlerë për të cilën nuk i është dhënë faturë. Pagesa e doganës në shumën 201.700 lekë, e vërtetuar me deklaratën doganore R*****, datë 25.04.2014, është kryer nga vëllai i bashkëshortes në RFZ Bank, në shumën 202.404 lekë. Përsa i përket shumës së dhuruar nga prindërit e bashkëshortes për blerjen e këtij automjeti, sqaroi se, në kushtet që vlera është e vogël, nuk kanë deklarata noteriale. Fakti i dhurimit vërtetohet me pagesën doganore të kryer nga vëllai i saj. **Paraqiti:**

- Depozitim datë 25.04.2014, në RFZ Bank, nga J. Meçka, në favor të Degës së Thesarit, Tiranë. Shuma 202.404 lekë. Përshkrimi i veprimit “I***** E. B “Urdhër çlirimi datë 25.04.2014, importues E. B, I*****”.
- Deklaratë doganore, datë 25.04.2014, importues E. B, të automjetit Ford Fiesta, viti 2012. Vlera 100.000 lekë. Detyrimi doganore 201.700 lekë.

- ✓ Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:
- ✓ Automjeti Ford Fiesta është blerë në vitin 2014, në vlerën 100.000 lekë si dhe i janë kryer shërbime shtesë e shpenzime doganore, me vlerë totale rreth 350.000 lekë.
- ✓ Automjeti është shitur në vitin 2018 në vlerën 4.000 euro.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR. Automjeti është shitur në vitin 2018.

Pasuria nr. 4

- ❖ Automjet tip Smart ForFour, viti 2005, me targë *****, në emrin tim, blerë në vitin 2022, me faturë shitblerje datë 10.03.2022. **Vlerë:** 1.300 euro. **Pjesë takuese:** 100%, me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga pagat. Bashkëlidhur deklaratës:
 - Faturë tatimore shitje, datë 10.03.2022, palë shitëse Seo-Smart, Durrës, palë blerëse Alfred Elezi, të automjetit Smart Forfour, viti 2005, kundrejt çmimi 1.300 euro.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. ***, datë 18.08.2023, konfirmon se shtetasi Alfred Elezi, ka aktualisht të regjistruar automjetin me targë *****. Bashkëlidhur:
 - Faturë tatimore shitje, datë 10.03.2022, palë shitëse Seo-Smart, Durrës, palë blerëse Alfred Elezi, të automjetit Smart Forfour, viti 2005, kundrejt çmimi 1.300 euro.
 - Akt shitje, datë 10.03.2022, nënshkruar ndërmjet shoqërisë Seo-Smart shpk dhe Alfred Elezi, të automjetit tip Smart ForFour, kundrejt vlerës 1.300 euro.
 - Dokumentacioni ligjor i automjetit, regjistruar në emër të Alfred Elezi.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

Pasuria nr. 5

- ❖ Llogari bankare në Tirana Bank, hapur në datë 06.01.2011 dhe gjendje në datë 24.02.2023, vlerën 2.713 lekë. **Burimi i krijimit:** pagat mujore nga institucioni buxhetor. Bashkëlidhur deklaratës:
 - Nxjerrje llogarie në emër të Alfred Elezi, pranë Tirana Bank, me gjendje në datë 24.02.2023, në vlerën 2.713 lekë.
- ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. ****, datë 08.08.2023, konfirmon llogari në emër të Alfred Elezi, me gjendje në datë 24.02.2023, në vlerën 2.713 lekë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Tirana Bank.

Pasuria nr. 6

- ❖ Llogari bankare në RFZ Bank, hapur në datë 23.11.2004 dhe gjendje në datë 10.03.2023, vlerën 543.659 lekë, nga të cilat, 200.000 lekë janë overdraft dhe 343.659 lekë kursime të miat.
Bashkëlidhur deklaratës:
 - Vërtetim nr. ** prot., datë 10.03.2023, nga RFZ Bank për Alfred Elezi, në të cilën konfirmohet se disponon llogari, me gjendje në datë 20.02.2023, në vlerën 543.659 lekë

✚ **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. **, datë 07.08.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të shtetasit Alfred Elezi dhe gjendjen në llogari, datë 10.03.2023, në vlerën prej 373.659 lekë. Llogaria e lidhur me overdraft, limit 200.000 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e RFZ Bank.
- ✓ Gjendje cash në familje nga kursimet 2001 - 2023 në vlerën 685.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat janë të mjaftueshme për realizimin e gjendies cash.

A/2 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga dhe shpërblime në Komisarlatin e Policisë Tropojë. Periudha 16.08.2001 - 31.12.2001. Shuma e të ardhurave **117.814 lekë**.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime në Drejtorinë e Policisë Kukës. Periudha 01.01.2002 - 15.05.2002. Shuma e të ardhurave **131.605 lekë**.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime në Komisarlatin e Policisë Has. Periudha 16.05.2002 - 15.09.2003. Shuma e të ardhurave 528.040 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime në Komisarlatin e Policisë Kukës. Periudha 16.09.2003 - 31.12.2004. Shuma e të ardhurave 640.043 lekë. **Në total, sa më sipër, 1.417.502 lekë**.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime, kredituar në RFZ Bank, gjithsej **18.242.312 lekë** dhe në Tirana Bank **gjithsej 82.525 lekë**, për punësimin pranë institucioneve në vijim:
 - Në Komisarlatin e Policisë Kukës. Periudha 16.09.2003 - 31.12.2004.
 - Në Drejtorinë e Policisë Kukës. Periudha 24.12.2007 - 02.02.2010.
 - Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Periudha 03.02.2010 - 17.01.2011.
 - Në Komisarlatin Malësi e Madhe. Periudha 18.01.2011 - 02.08.2011.
 - Në Drejtorinë e Policisë Kukës. Periudha 03.08.2011 - 20.09.2011.
 - Në Komisarlatin e Policisë Vlorë. Periudha 21.09.2011 - 11.11.2012.
 - Në Komisarlatin e Policisë Lushnje. Periudha 12.11.2012 - 03.11.2013.
 - Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës. Periudha 04.11.2013 - 05.08.2014.
 - Në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat. Periudha 06.08.2014 - 10.01.2016.
 - Në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Periudha 11.01.2016 - 24.08.2016.
 - Në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Periudha 25.08.2016 - 30.04.2019.
 - Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Periudha 17.11.2021 - 17.04.2022.
 - Në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Periudha 18.04.2022 – 21.02.2023.
- Shuma monetare të dërguara nga motra ime A. A dhe kunati im (bashkëshorti i motrës) F. A nëpërmjet transfertës me Money Gram, në shumën 1.500 euro.
- Të ardhura të bashkëshortes në Kukës Televizion, për periudhën 07.06.2011 - 28.12.2011.
- Shuma e të ardhurave 127.776 lekë.
- Të ardhura të bashkëshortes në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 02.04.2012 - 05.05.2014. Shuma e të ardhurave 425.341 lekë.
- Të ardhura të bashkëshortes në Kukës Televizion, për periudhën 30.01.2015 - 04.05.2017. Shuma e të ardhurave 603.078 lekë.
- Të ardhura të bashkëshortes në Kukës Televizion, për periudhën 03.07.2017 - 28.06.2019. Shuma e të ardhurave 666.000 lekë.

- Të ardhura të depozituara nga familja e bashkëshortes në llogarinë e saj rrjedhëse në Raiffeisen Bank. Shuma 85.867 lekë.
- Të ardhura nga pagat e bashkëshortes në institucione buxhetore dhe arkëtime nga të tretë, në shumën totale 2.781.880 lekë (nga të cilat, paga 2.673.671 lekë; shpërblime 20.000 lekë dhe nga të tretë 88.209 lekë), si më poshtë:
 - Prefektura Kukës, specialiste në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Drejtoria e OSSHE Tiranë me detyrë specialiste.
 - Për periudhën 2019 - 2023, është nxjerrë vërtetimi nga RFZ Bank datë 23.2.2023.
- Të ardhura të vjehrrës sime, R. Meçka, si aksionere në Televizion Kukësi, për periudhën 07.06.2011 - 19.04.2018, në shumën 3.233.255 lekë dhe për periudhën 19.04.2018 - 28.06.2019, në shumën 627.000 lekë.
- Të ardhura të vjehrrës sime, R. Meçka, si aksionere në Televizion Kukësi, për periudhën 2007 - 2011, në shumën 1.097.830 lekë.
- Kredi në emër të L dhe R. Meçka në RFZ Bank, marrë për blerjen e apartamenteve të subjektit dhe bashkëshortes (shlyer në vitin 2021). Shuma 12.000.000 lekë.
- Të ardhura të vjehrrës sime, R. Meçka, nga punësimi në Televizion Kukësi dhe burime të tjera, për periudhën 18.09.2020 - 08.07.2022, në shumën 1.097.180 lekë.
- Të ardhura të vjehrrit tim L. Meçka, nga punësimi në kompaninë “Astra” shpk., për periudhën 2008 - 2013 dhe nga qiraja, në shumën 15.344.876 lekë (nga të cilat, paga 14.594.876 lekë dhe qiraja 740.000 lekë).
- Të ardhura të vjehrrit tim, L. Meçka, si administrator në Televizion Kukësi dhe burime të tjera, për periudhën 18.09.2020 - 08.07.2022, në shumën 1.097.180 lekë.
- Të ardhura të vjehrrit tim, L. Meçka, për periudhën 2007 - 2022, në shumën totale prej 41.291.116 lekë, nga puna si:
 - Administrator në Televizion Kukësi sh.a. Menaxher/Operator i kompanisë “Astra Albania” sh.a.
 - Menaxher/Operator i kompanisë “Adriatic Game SH. A” ,
- Burime të tjera:
- Të ardhura të vjehrrit tim, L. Meçka, si administrator në Televizion Kukësi, për periudhën 07.06.2011 - 28.06.2019, në shumën 4.477.240 lekë.
- Të ardhura të vjehrrit tim, L. Meçka, nga familjarë të tij (vëllai N. Meçka) dhe të ardhura nga shitje apartamenti për periudhën 2020 - 2021. Shuma e të ardhurave 36.874 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 26.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Has, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Alfred Elezi, gjatë periudhës 15.05.2002 - 15.09.2003, në shumën totale 528.040 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Alfred Elezi, gjatë periudhës 2002 - 2004, në shumën totale 771.648 lekë.
- Vërtetim mbi produktet bankare të klientit Alfred Elezi, pranë Raiffeisen Bank, periudha 2005 - 2022.

- Vërtetim, datë 19.04.2018, nga NBG Bank, për shtetasen R. Meçka, e cila është kliente e bankës si pagamarrëse prej datës 07.06.2011.
- Të ardhurat nga paga për periudhën 07.06.2011 - 19.04.2018 janë 3.233.255 lekë.
- Vërtetim, datë 19.04.2018, nga NBG Bank, për shtetasin L. Meçka, i cili është klient i bankës si pagamarrës, prej datës 07.06.2011.
- Të ardhurat nga paga për periudhën 07.06.2011 - 19.04.2018 janë 3.508.980 lekë.
- Mandate (dokumentacion jo i plotë), lidhur me përfitimin e transfertave financiare me përfitues Alfred Elezi, shumat 100 euro, datë 22.05.2021 650 euro, datë 11.01.2022.

+ **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Alfred Elezi dhe pagat e kreditura gjatë periudhës shkurt 2005 mars 2023, në vlerën totale rreth 18.325.000 lekë.

+ **Tirana Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 08.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Alfred Elezi dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 06.01.2011- 28.02.2011, në vlerën totale rreth 82.500 lekë.

+ **Unioni Financiar** me shkresën nr. *** prot., datë 18.08.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Alfred Elezi kanë mbërritur 5 transaksione me vlerë totale 1.200 euro.

+ **AK Invest** me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Alfred Elezi ka patur një transaksion si përfitues fondesh nga A. A, datë 26.02.2020, vlera 100 euro.

+ **Qendra Kombëtare e Biznesit**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasit L. Meçka dhe R. Meçka, figurojnë të regjistruar si: Person Juridik, me NIPT *****, status aktiviteti “pezulluar”. Sipas ekstraktit historik bashkëlidhur shkresës, aktiviteti “Luis Bingo” është çelur në datë 08.07.1997, me veprimtari “në fushën e bingos e lojrave të fatit” dhe në datë 24.08.2009 ka kaluar në status pezulluar Person Juridik, me NIPT *****, status aktiviteti “aktive”. Sipas ekstraktit historik bashkëlidhur shkresës, shoqëria “Televizioni Kukës” sha është themeluar në datë 05.06.2000. Përveç sa më lart, shtetasja, figuron gjithashtu e regjistruar si Person Juridik, me NIPT *****, status aktiviteti “active”. Sipas ekstraktit historik bashkëlidhur shkresës, shoqëria “Rrjeti Televizioneve Lokale VHF” është themeluar në datë 03.02.2020, me veprimtari në fushën e mediave audiovizive dhe televizive. Shtetasja R. Meçka figuron administratore dhe aksionere me 34% të kuotave.

+ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Alfred Elezi ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: janar 2012 - korrik 2023 pranë Drejtorive të Policisë Qarku Vlorë, Fier, Berat, Lezhë, Shkodër si dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Gjithashtu, konfirmohen të ardhura të realizuara nga L. Meçka gjatë periudhës janar 2012 - mars 2012 dhe prill 2013 - qershor 2023, pranë subjekteve Televizioni Kukës dhe Adriatik Games, ndërsa, shtetasja R. Meçka ka përfituar të ardhura për periudhën janar 2012 - gusht 2022 pranë subjektit Televizioni Kukës.

- ✚ **Me process-verbalin e datës 04.01.2024**, subjekti paraqiti sqarimet e tij lidhur me fondet e transferuara nga motra e tij, A. A, me Money Gram, të cilat janë kryer në formën e dhuratës, për të e familjen e tij dhe janë përdorur për nevoja familjare.

A/2 DETYRIMET FINANCIARE

- ✓ Kredi në NBG Bank, përfituar sipas kontratës nr. *** rep., nr. ** kol., datë 12.01.2011, në vlerën 85.000 euro dhe afat 25 vite. Kredia është marrë nga ana ime dhe e bashkëshortes, dorëzanës babai i bashkëshortes L. Meçka, i cili për garantimin e kredisë ka lënë si kolateral në NBG Bank, një pronë truall me sip. 500 m², në Fushë Mëzes, Kashar, Tiranë. Qëllimi i kredisë ka qenë për blerje banese (ose lokali) nga firma “Elvis” shpk, duke kaluar në llogarinë e firmës shumën 82.818 euro dhe diferencën 60.000 euro, për ti shyer dorazi cash nga vjehri. Në kushtet e pamundësisë për të paguar shumën, marrëveshja u ndërpre dhe shuma 82.818 euro është kthyer mbrapsht nga firma “Elvis” shpk dhe pas kësaj është nënshkruar një marrëveshje, sipas së cilës, shuma e kthyer cash nga shoqëria do të përdoret nga prindërit e bashkëshortes për interesa të biznesit të tyre. Kjo kredi, edhe pse është në emrin tim dhe bashkëshortes, në asnjë rast nuk është përfituar apo kemi paguar këste të saj. Detyrimi i pashlyer i kredisë në shumën 62.428 euro. **Bashkëlidhur deklaratës.**
- Vërtetim nr. prot. *****, datë 27.02.2023, nga ABI Bank, drejtuar Alfred Elezi, i cili në datë 25.11.2011 ka përfituar kredi në vlerën 85.000 euro, afat shlyerje 06.01.2036. Shuma e mbetur pashlyer e kredisë në vlerën 62.428 euro.
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. ** kol., datë 12.01.2011, nënshkruar midis Bankës Kombëtare të Greqisë dhe shtetasve Alfred Elezaj dhe Julinda Elezaj; dorëzanës L. Meçka, të shumës 85.000 euro me qëllim blerjen e tre apartamenteve me adresë në Fushë Mëzez, Tiranë. Pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 60.000 euro. Afati i kredisë 25 vjet banka do të depozitohet shumën e kredisë në numrin e llogarisë që shitësi i pasurisë së paluajshme, për blerjen e të cilës po merret kredia në bazë të kontratës së shitblerjes datë 10.11.2010, mban me Bankën Kombëtare të Greqisë. Kredimarrësit marrin përsipër detyrimin për të bërë regjistrimin hipotekor në favor të bankës, pronën lloji “Truall”, me nr. pasurie ***, vol. **, fq. ***, ZK. ****, me sip. 500 m², adresë në Fushë Mëzez, Tiranë. Prona është regjistruar pranë ZRPP, në pronësi të L. Meçka.
- Kontratë (porosi për blerje lokali), nënshkruar në datë 10.11.2010, nënshkruar ndërmjet palës sipërmarrëse shoqëria “Elvis” shpk dhe palës porositëse Alfred Elezaj, i pranishëm përfaqësues i NBG Bank. Objekti i kontratës është shitblerja e një lokali me sip. 100 m² për të cilin pala porositëse ka paguar paraprakisht, shumën 60.000 euro cash vlera totale e shitblerjes është 150.000 euro. Diferenca e shumës 90.000 euro do të likuidohet në muajin dhjetor 2010.
- Revokim kontrate (porosie për blerje lokali, banese), nënshkruar në datë 20.02.2011, ndërmjet palës sipërmarrëse shoqëria “Elvis” shpk dhe palës porositëse Alfred Elezi. Palët kishin rënë dakort që porositësi të blinte një lokal 100 m² ose apartament banimi nga sipërmarrësi, pasi t’i paguante shumën prej 82.800 euro nëpërmjet llogarisë bankare dhe shumën 60.000 euro, cash, shumë që nuk është arritur të kryhet nga porositësi Alfred Elezi.
- ✚ **Më datë 17.02.2011**, është bërë kalimi i fondeve në shumën 82.818 euro nga llogaria e porositësit Alfred Elezi në NBG Bank tek llogaria e sipërmarrësit “Elvis” shpk. Duke qenë se porositësi Alfred Elezi nuk ka arritur të respektojë kontratën e porosisë, pasi nuk ka likuiduar pagesën cash

prej 60.000 euro, kontrata e porosisë e lidhur mes palëve, është e pavlefshme dhe revokohet. Porositësi Alfred Elezi mori cash shumën 82.818 euro nga shoqëria Elvis shpk, e shoqëruar me faturë nga kjo shoqëri.

- Akt marrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.04.2018, e shtetasve L. Meçka, R. Meçka, Alfred Elezi, Julinda Elezi. Palët Alfred Elezi, Julinda Elezi deklarojnë se më datë 20.02.2011 kanë kryer revokimin e kontratës së porosisë së nënshkruar me shoqërinë “Elvis” shpk, vlera e revokimit në shumën 82.818 euro, i është dhënë cash shtetasit L. Meçka më datë 22.02.2011. Pala L. Meçka deklaroi se është dakord të likuideojë kredinë dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e kredisë datë 12.01.2011.
- Bashkëlidhur, marrëveshja e nënshkruar mes palëve, datë 22.02.2011.
- Lëvizjet e llogarisë në emër të Alfred Elezaj pranë ABI Bank, gjatë periudhës 25.01.2011 - 06.02.2023. Evidentohet disbursimi i kredisë me vlerë 85.000 euro, në datë 25.01.2011. Në datë 17.02.2011, transferohet shuma 82.818 euro, në favor të Elvis shpk. Në vijim, lëvizjet bankare i përkasin shlyerjeve periodike të kredisë, vlerë e cila depozitohet cash cdo muaj në vlerën rreth 600 euro nga L. Meçka, deri në shkurt 2023.

✚ **ABI Bank me shkresën nr. **, datë 15.08.2023**, konfirmon llogari në emër të shtetasit Alfred Elezi, në të cilën, në datë 25.01.2011 është disbursuar kredia me vlerë 85.000 euro si dhe në datë 17.02.2011 është transferuar shuma 82.818 euro, në favor të Elvis shpk. Referuar dokumentacionit bankar, për këtë kredi, banka ka përfutuar si kolateral pasurinë banesë + truall me vlerë 282.065 euro. Detyrimi financiar i kredisë në datë 10.03.2023 është në vlerën 62.175 euro.

✚ **ASHK Drejtoritë Vendore Tiranë Veri, Kamëz Vorë, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **Në deklaratën Para Fillimit të Detyrës 2011**, subjekti deklaroi se ka marrë kredi në NBG Bank në shumën 85.000 euro, shkurt 2011, afat 25 vjet. Kësti mujor 602 euro. Kredia është marrë për blerje dhe akomodim banese. Detyrimi financiar 84.400 euro.

✚ **Në deklaratën Periodike Vjetore 2011**, deklaroi kredi në vlerën 6.622 euro, është likuiduar nga babai i bashkëshortes. Detyrimi financiar 79.000 euro.

✚ **Në deklaratën Periodike Vjetore 2012**, deklaroi kredi për blerje shtëpie, shlyer 1.500 euro dhe detyrimi financiar 82.500 euro.

✚ **Në deklaratën Pas Largimit 2023**, deklaroi kredi për blerje shtëpie, shlyer 7.600 euro dhe detyrimi financiar 70.000 euro.

✚ **Me proces-verbalin e datës 04.01.2024**, subjekti paraqiti sqarimet e tij lidhur me kredinë e mësipërme. Sqaroi se, kredia në NBG Bank është marrë me qëllim blerjen e lokalit prej 100 m², sipas kontratës së porosisë datë 10.11.2010 e lidhur mes tij, si palë blerëse dhe shoqërisë “Elvis” shpk. Kontrata e porosisë është nënshkruar me qëllim lëvrimin e kredisë. Fakti që në kontratën e kredisë është bërë shënimi për blerje apartamentesh, duhet të jetë një lapsus i punonjësit të bankës pasi në dokumentacionin e dërguar bankës, i ka dorëzuar kontratën e porosisë, nënshkruar mes tij, firmës dhe drejtorit të filialit të NBG Bank, datë 10.11.2010. Përfaqësuesi i bankës ka qenë prezent dhe ka nënshkruar kontratën e porosisë dhe mospërputhja e qëllimit të kontratës me atë të realizuar,

vlerëson se është lapsus. Kontrata e kredisë është firmosur nga ana e përfaqësuesve të bankës dhe ligjruar nga ana e noteres. Kontratës së kredisë i është bashkëlidhur një kontratë porosie jo noteriale pasi nuk i është kërkuar nga banka të jetë noteriale. Mospërputhjen e deklarimeve në kontratën datë 10.11.2010, ku citohet se “Objekti i kontratës është shitblerja e një lokali me sip. 100 m², për të cilin pala porositëse ka paguar paraprakisht shumën 60.000 euro cash, ndërsa, në kontratën e revokimit datë 20.02.2011, deklarohet se shuma 60.000 euro nuk është arritur të kryhet nga porositësi, ka të bëjë me kërkesat që kishte banka me kushtet e lëvrimin të kredisë. E vërteta është siç është sqaruar në kontratën e revokimit të kredisë, pra, që shuma nuk është paguar prej tij asnjëherë. Për kthimin mbrapsht të shumës 82.818 euro që i ka kaluar firmës “Elvis” shpk, është lëshuar një mandat të cilin ai nuk e disponon dhe nuk mund ta siguroj pasi pronari i firmës “Elvis” shpk nuk jeton më dhe familjarët e tij gjithashtu nuk e disponojnë, referuar kjo edhe kohës së largët të lëshimit të saj. Në kontratën e kredisë, në nenin 7 të saj, ndalohet shlyerja dhe mbyllja e kredisë vitin e parë të saj. Gjithashtu kishin paguar shpenzimet për marrjen e kredisë. Në këto kushte menduan që vlerën e kredisë t’ia jepnin vjehrrit të tij L. Meçka, për interesin e tij, me kushtin që ai do të paguante kështu e kredisë sipas marrëveshjes së huasë me bankën. Më datë 22.02.2011 kanë bërë nënshkrimin mes palëve për këtë fakt, formalizuar më vonë nëpërmjet akt marrëveshjes noteriale datë 25.04.2018 dhe e provuar kjo me mandate pagesat për shlyerjet e kësteve të kredisë, kyyer nga L dhe R. Meçka. Kjo kredi, edhe pse rezulton në emrin e tij dhe bashkëshortes, në asnjë rast nuk është përfituar prej tyre si dhe nuk kanë paguar detyrime financiare të saj. Fondet i janë dhënë prindërve të bashkëshortes si individë, për interesa të tyre personale. Lidhur me deklaratimet e kryera ndër vite, sqaroi se si edhe më lart, burimi financiar i deklaruar nga kredia në NBG Bank është lapsus gjatë plotësimit të deklaratës. Kredia e marrë në NBG Bank është vënë në dispozicion të vjehrrit dhe është përfituar në vitin 2011, ndërsa apartamenti është blerë e shlyer në vitin 2008.

✚ **ASHIK, Dreitoritë Vendore Tiranë Veri, Kamëz Vorë, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **Me inventarin e datës 18.03.2024 subjekti paraqiti:** Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 13.03.2024, e shtetasit Lutfi Meçka, i cili deklaroi se në bazë të akt marrëveshjes nr. *** rep., nr. ** kol., datë 25.04.2018, në mes të tjerave, shuma 82.818 euro, marrë prej tij dhe bashkëshortes, është përdorur për blerje të pajisjeve për TV kabllor në Kukës dhe punime të godinës së TV Kukës. Shuma e mbetur për tu paguar nga kredia e marrë nga dhëndri i tij, Alfred Elezi dhe vajza Julinda Elezi, do të likuidohet totalisht prej tij, brenda muajit prill 2024.

❖ Bazuar në deklarinimin e subjektit dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- ✓ Në datë 10.11.2010, subjekti nënshkruan një kontratë porosie për blerje lokali/njësie, me vlerë totale 150.000 euro, ku, midis të tjerave, citohet se është paguar paraprakisht nga subjekti një pjesë e saj prej 60.000 euro dhe diferenca do të likuidohet në dhjetor 2010. Subjekti përfiton kredi në datë 12.01.2011, pranë ish NBG Bank (aktualisht ABI Bank), me vlerë 85.000 euro dhe qëllim blerjen e pasurisë së paluajtshme “njësi”, në shumën totale prej 150.000 euro.
- ✓ Kredia prej 82.818 euro transferohet më datë 17.02.2011 nga llogaria e subjektit Alfred Elezi tek llogaria e sipërmarrësit “Elvis” shpk. Në datë 20.2.2011, palët nënshkruajnë revokim të

kontratës së datës 10.11.2010, për shkak të moslikuidimit të pagesës prej 60.000 euro nga ana e subjektit. Sipas kontratës, pala sipërmarrëse deklaroi se pala porositëse (subjekti) merr mbarsht fondet e paguara prej 82.818 euro.

- ✓ Në kushtet që kredia e marrë për këtë qëllim nuk u realizua, fondet e kredisë së tërhequra mbarsht dhe detyrimet përkatëse, subjekti i transferon tek babai i bashkëshortes, pasi i nevojiteshin për përdorim personal. Kredia, nga momenti i marrjes së saj e deri më tani, paguhet rregullisht në ABI Bank nga babai i bashkëshortes në ABI Bank.
- ❖ Llogari overdraft Në RFZ Bank, në emër të Alfred Elezi, çelur në 23.11.2004, në shumën prej 200.000 lekë. E papërdorur. **Trajtuar më lartë**

A/3 Shpenzimet e deklarueshme

- ❖ **Të viti të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit të vlerësimit ose personave të lidhur me të. Periudha 01.01.2022-31.12.2022.**

- Shpenzimet e telefonit (.380), në emër të Alfred Elezi, për vitin 2022, në shumën 10.334 lekë.
- Shpenzimet e telefonit (.085), në emër të Alfred Elezi, për vitin 2022, në shumën 6.700 lekë.
- Shpenzimet e telefonit (.729), në emër të Alfred Elezi por përdoret nga familja, për vitin 2022, në shumën 2.540 lekë.
- Shpenzimet e telefonit (.611), në emër të Alfred Elezi por përdoret nga djali M, për vitin 2022, në shumën 6.400 lekë.
- Pagesë Netflix për vitin 2022, në shumën 7.228 lekë.
- Shpenzimet e telefonit (.377), në emër të R. Meçka por përdoret nga bashkëshortja Julinda Elezi, për vitin 2022, në shumën 15.200 lekë.
- Për Vitin 2022 kam shpenzuar për furnizimin me ujë, kontrata nr. *****, në emër të Alfred Elezaj (Elezi), shumën 9.618 lekë, paguar në 2023.
- Për Vitin 2022 është shpenzuar shuma 70.466 lekë + 24.000 lekë (debi e prapambetur, sipas akt marrëveshjes), për pagesën e energjisë elektrike të banesës sime, kontrata nr. *****, e cila është regjistruar në fakt në emër të babait të bashkëshortes L. Meçka për shkak se lidhja e energjisë është bërë në bazë të kontratës së porosisë së apartamentit dhe unë nuk kam kryer veprimet për ndryshimin e kontratës.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✚ **FSHU** me shkresën nr. ***** prot., datë 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi me energji elektrike në emër të Alfred Ismail Elezi. Konfirmohet se me gjeneralitetet Alfred Elezi, figurojnë të regjistruara tre kontrata furnizimi me energji elektrike të cilat pas verifikimit rezultojnë se nuk janë në emër të subjektit të vlerësimit.
- ✚ **15 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve**, me shkresat nr. ***** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

- ✚ **Vodafone Albania sh. a**, me shkresën nr. ***, datë 06.11.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Alfred Elezi (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) figurojnë 2 numra; nr...085, datë aktivizimi 12.01.2021 (jo aktive në datë 23.10.2023), nr. ***, datë aktivizimi 02.08.2022, shpenzimi i të cilave gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022 është në vlerën totale prej 15.500 lekë. Shtetasit Alfred Elezi (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) i korrespondon një numër telefoni ...380, aktivizuar prej datës 03.01.2008. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 10.200 lekë. Shtetases Julinda Elezi i korrespondon një numër telefoni ... 729, aktivizuar prej datës 19.07.2022. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 3.660 lekë. Shtetasve M. Elezi, E. Elezi dhe E. Elezi nuk i korrespondojnë asnjë numër celular të kësaj shoqërie.
- ✚ **One Albania sh. a** me shkresën nr. ***, datë 11.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të regjistruar pranë kësaj kompanie.
- ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abissnet sh. a** me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Digicom sh. a**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ Me proces-verbalin e datës 04.01.2024, subjekti paraqiti:
 - Fatura tatimore të lëshuara nga FSHU për L. Meçka, nr. kontrate TRIF*****, periudha janar - dhjetor 2022. Shuma totale e faturuar 70.461 lekë.
 - Mandat pagesa të UKT pranë Easy Pay, klienti Alfred Elezaj, kod klienti ***** periudha janar - dhjetor 2022. Shuma totale e faturuar 9.700 lekë.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 117.000 lekë.

❖ *A/4 Udhëtimet e tre viteve të fundit*

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

- Udhëtim në Angli në banesën e vajzës së xhaxhait tim, J. Istrefi, nga data 19.09.2022 - 23.09.2022. Shpenzuar bileta e udhëtimit dhe të tjera në shumën totale 900 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.

- Udhëtim në Kosovë, nga data 22.06.2021 - 23.06.2021, vizitë tek shtëpia e hallës time, F. D (Elezaj). Shpenzuar shuma totale 100 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.
- Udhëtim në Kosovë, nga data 16.12.2020 - 16.12.2020. Shpenzuar shuma totale 50 euro. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.
- Udhëtim në Kosovë, nga data 04.07.2020 - 04.07.2020. Shpenzuar shuma totale 100 euro. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.
- Udhëtime në Kosovë të bashkëshortes: 23.01.2021 - 23.01.2021; 10.05.2021 - 10.05.2021 28.05.2021 - 28.05.2021; 21.11.2021 - 21.11.2021; 05.12.2021 - 05.12.2021; 19.12.2022 - 19.12.2022; 19.03.2022 - 19.12.2022. Shpenzime totale 350 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Konfirmim nga sistemi TIMS për subjektin dhe familjarët e tij ku vërtetohen lëvizjet jashtë shtetit, si më poshtë vijon:
 1. Alfred Elezi.
Dalje 04.07.2020 - hyrje 04.07.2020;
Dalje 16.12.2020;
Dalje 22.06.2021 - hyrje 23.06.2021;
Dalje 19.09.2022 - hyrje 25.09.2022;
 2. Julinda Elezi: Dalje 04.07.2020 - hyrje 04.07.2020;
Dalje 23.1.2021;
Dalje 10.05.2021;
Dalje 28.5.2021;
Dalje 21.11.2021;
Dalje 05.12.2021; Dalje 19.02.2022;
Dalje 19.03.2022 - Hyrje 15.04.2022;

✚ **Me proces verbalin e datës 04.01.2024**, subjekti paraqiti sqarimet e tij lidhur me udhëtimet e kryera prej tij dhe familjarëve. Sqaroi se të gjitha lëvizjet e bashkëshortes së tij në Kosovë kanë qenë ditore, gjatë kohës që ka shkuar të prindërit e saj në Kukës. Ajo ka punuar me kohë të plotë e pa shkëputje nga puna. Ka udhëtuar në Angli, në banesën e vajzës së xhaxhait J. I, nga data 19.09.2022 deri në datë 23.09.2022 dhe vlera e shpenzimeve ka qenë 900 euro. Nuk disponon dokumentacion për të provuar shpenzimet por vetëm biletën e udhëtimit, e cila ka kushtuar 370 euro. **Paraqiti:**

- Vërtetim nr. Extra prot., datë 28.12.2023, nga OSHEE, për Juliana Elezi, e cila është punonjëse e këtij institucioni prej datës 04.03.2020.
- ✓ Konfirmim biletë avioni për Alfred Elezi, Tiranë - Londër, datë 19.09.2022. Vlera 370 euro.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga RSH gjatë periudhës 2020-2022 të subjektit dhe personave të lidhur me të. Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar rezultojnë në total rreth 1.500 euro, konvertuar rreth 171.000 lekë.

❖ Për arsimin e fëmijëve, madhor apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimi, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32 të ligjit të vlerësimit.

- Djali M. Elezi ndjek shkollën publike 9-Vjeçare, Mëzez, prej vitit 2016.
- Djali E. Elezi ndjek shkollën publike 9-Vjeçare, Mëzez, prej vitit 2019.
- Vajza E. Elezi ndjek studimet në institucionin arsimor privat shkolla “TES”, prej vitit 2022.
- Për vitin 2022 janë kryer 3 pagesa në shumën 203.334 lekë, ndërsa, diferenca 91.667 lekë do të paguhet në periudhën 01-05.04.2023, sipas kontratës. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë regjistrimi, nënshkruar në datë 06.09.2022, ndërmjet GEA shpk dhe Alfred e Julinda Elezi, për tarifën e shkollimit vjetor të fëmijës E. Elezi, në vlerën totale prej 395.000 lekë.

✚ Me process-verbalin e datës 04.01.2024. subjekti paraqiti:

- Vërtetim pagesash nr. prot. 100, datë 27.12.2023, nga Green Education Albania për Alfred Elezi, i cili, për fëmijën E. Elezi ka kryer pagesën për vitin shkollor 2022 - 2023, në vlerën 295.000 lekë, nga të cilat, 204.000 lekë janë shlyer në shtator dhjetor 2022 dhe 91.000 lekë në prill 2023.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e personave të lidhur gjatë periudhës 2022 - 2023 rezultojnë në total rreth 204.000 lekë.

A/7 DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR BASHKËSHORTES JULINDA ELEZI

❖ Apartament banimi me sip. të banuar 112.5 m² dhe sip. totale 131.8 m² (bashkuar nga dy apartamente banimi në një, përkatësisht, njëri apartament me sip.62.8 m² dhe tjetri me sip. 49.7 m²), blerë me anë të kontratës së shitjes nr. **** rep., nr. *** kol., datë 18.09.2008, nga shoqëria “Ilad” shpk, në vlerën 38.250 euro, por paguar në fakt nga babai i bashkëshortes, L. Meçka, sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.01.2008, në vlerën 59.310 euro dhe 5.690 euro, punime shtesë dhe arredim të kryer nga unë dhe bashkëshorti. Vlera 65.000 euro. Pjesë takuese 100% me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** shuma prej 5.690 euro është siguruar nga të ardhurat e mia dhe bashkëshortit gjatë periudhës 2001-2009, ndërsa, shuma 59.310 euro është dhuratë nga prindërit e mi, sipas akt dhurimit datë 25.01.2001, i formalizuar me aktin noterial të dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.04.2018 (e bërë lapsus nga noterja shuma prej 59.300 euro). Vlera është transferuar nga llogaria e L. Meçka në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “Ilad” shpk, vërtetuar kjo me anë të transfertës datë 25.01.2008. Për shlyerjen e vlerës totale për blerjen e 3 apartamenteve është marrë kredi nga prindërit e bashkëshortes, në shumën 12.000.000 lekë. **Trajtuar më lart.**

❖ Automjet Renault Tëingo, me targë *****, në emrin tim, me vlerë 250.000 lekë, blerë në vitin 2007 dhe shitur 100.000 lekë, në vitin 2015. Pjesë takuese 100%, me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** të ardhurat e mia dhe kursimet e bashkëshortit nga viti 2001 deri në 2007. **Trajtuar më lart.**

- ❖ Automjet Ford Fiesta, me targë ***** (i dëmtuar pjesërisht para në momentin e blerjes), në emrin tim, e blerë në vitin 2014, në shumën 100.000 lekë, datë 11.04.2014. Pjesë takuese 100% me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** të ardhurat nga pagat e mia të vitit 2014, kursimet e bashkëshortit, si dhe 350.000 lekë (202.404 lekë për pagesën e doganës) dhuratë nga prindërit e mi L. Meçka e R Meçka. E shitur në vlerën 4.000 euro, datë 10.12.2018. **Trajtuar më lart.**
- ❖ Automjet tip Smart, viti 2005, me targë *****, në emër të bashkëshortit tim, blerën në vitin 2022 me faturë shitblerje datë 10.03.2022. Vlerë 1.300 euro. Pjesë takuese 100% me bashkëshorten. **Trajtuar më lart.**
- ❖ Gjendje likuiditete në RFZ Bank, në vlerën 67.365 lekë. Pjesë takuese 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim, datë 20.02.2023, nga RFZ Bank për Julinda Elezi, në të cilën konfirmohet se disponon llogari, me gjendje në datën 20.02.2023, në vlerën 67.365 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **, datë 07.08.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emer të shtetasës Julinda Elezi dhe gjendjen në llogari datë 10.03.2023, në vlerën prej 77.824 lekë. Ndrvshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tvre në data të ndrvshme.

A/8 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE TË PERSONIT TË LIDHUR BASHKËSHORTES

- Të ardhura nga paga ime në Kukës Televizion, për periudhën 07.06.2011 - 28.12.2011. Shuma e të ardhurave 127.776 lekë.
- Të ardhura nga paga ime në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 02.04.2012 - 05.05.2014. Shuma e të ardhurave 425.341 lekë.
- Të ardhura nga paga ime në Kukës Televizion, për periudhën 30.01.2015 - 04.05.2017. Shuma e të ardhurave 603.078 lekë.
- Të ardhura nga paga ime në Kukës Televizion, për periudhën 03.07.2017 - 28.06.2019. Shuma e të ardhurave 666.000 lekë.
- Të ardhura të depozituara nga familja ime në llogarinë time rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank. Shuma 85.867 lekë.
- Të ardhura nga pagat e mia në institucione buxhetore dhe arkëtime nga të tretë, në shumën totale 2.781.880 lekë (nga të cilat paga 2.673.671 lekë; shpërblime 20.000 lekë dhe nga të tretë 88.209 lekë), si më poshtë: Prefektura Kukës, specialiste në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Drejtoria e OSSHE Tiranë, me detyrë specialiste. Për periudhën 2019 - 2023, është nxjerrë vërtetimi nga RFZ Bank, datë 23.2.2023.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Lëvizjet e llogarisë në emër të Julinda Elezi pranë BKT, gjatë periudhës 02.04.2012-28.01.2016.
- Lëvizjet e llogarisë në emër të Julinda Elezi pranë ABI Bank, gjatë periudhës 02.05.2019 - 19.10.2020.

- Vërtetim mbi produktet bankare të klientit Julinda Elezi pranë Raiffeisen Bank, periudha 2005 - 2022.

+ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. * **, datë 07.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Julinda Elezi dhe pagat e kreditura gjatë periudhës shkurt - maj 2011, në shumën totale rreth 64.000 lekë si dhe maj 2019 - mars 2023, në vlerën totale rreth 2.913.000 lekë.

+ **Banka Kombëtare Tregtare**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, konfirmon llogari në emër të shtetases Julinda Elezi dhe të ardhurat e kredituara nga pagat e ISSH si dhe nga raportet e lejes së lindjes, gjatë periudhës 02.04.2012 - 05.05.2014, në vlerën totale rreth 425.000 lekë.

+ **ABI Bank** me shkresën nr. ***, datë 15.08.2023, konfirmon llogari në emër të shtetases Julinda Elezi dhe të ardhurat e kredituara nga pagat e Televizioni Kukës shpk si dhe nga raportet e lejes së lindjes, gjatë periudhës janar 2015 - qershor 2019, në vlerën totale rreth 1.230.000 lekë.

+ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. **** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se, Julinda Elezi ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: mars 2012 - mars 2013, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore:

- janar 2015 - gusht 2020, pranë Televizionit Kukës;
- mars 2019 -janar 2020, pranë Prefekturës Kukës;
- mars 2020 - qershor 2023, pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

✓ Të ardhurat e bashkëshortes nea paga, për periudhën shkurt 2011 - mars 2023. konfirmohen në vlerën totale rreth 4.568.000 lekë.

DETYRIME FINANCIARE

❖ Kredi në NBG Bank, përfituar sipas kontratës nr. *** rep., nr. ** kol., datë 12.01.2011, në vlerën 85.000 euro dhe afat 25 vite. Kredia është marrë nga ana ime dhe e bashkëshortes, dorëzanës babai i bashkëshortes L. Meçka, i cili për garantimin e kredisë ka lënë si kolateral në NBG Bank, një pronë truall me sip 500 m², në Fushë Mëzez, Kashar, Tiranë. Qëllimi i kredisë ka qenë për blerje banese (ose lokali) nga firma “Elvis” shpk, duke kaluar në llogarinë e firmës shumën 82.818 euro dhe diferencën 60.000 euro, për ti shyer dorazi cash nga vjehri. Në kushtet e pamundësisë për të paguar shumën, marrëveshja u ndërpre dhe shuma 82.818 euro është kthyer mbrapsht nga firma “Elvis” shpk dhe pas kësaj është nënshkruar një marrëveshje sipas së cilës shuma e kthyer cash nga shoqëria do të përdoret nga prindërit e bashkëshortes, për interesa të biznesit të tyre. Kjo kredi, edhe pse është në emrin tim dhe bashkëshortes, në asnjë rast nuk është përfituar apo kemi paguar këste të saj. Detyrimi i pashlyer i kredisë në shumën 62.428 euro. **Trajtuar më lart.**

+ **Banka e Shqipërisë, Intesa SanPaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Fibank, Banka Amerikane e Investimeve, Credins Bank, Union Bank, OPT Bank, Raffeißen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Credins Invest konfirmojnë se subjekti Alfred Elezi, nuk është klient i tyre çka përputhet me deklarin e tij.**

- ✚ **ASHK**, Zyrat/Drejtoritë Vendore- Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Lezhë Lushnjë, Krujë, Gramsh, Kuçovë, Pukë, Malësi e Madhe, Kukës, Kavajë, Bulqizë Skrapar nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ **Easy Pay**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Alfred Elezi rezulton kredimarrës pranë institucionit lute Credit për të cilën ka kryer 11 transaksione pagesash, në shumën totale rreth 50.000 lekë, gjatë periudhës Tetor 2019 - Gusht 2020. Gjithashtu, shtetasja Julinda Elezi, rezulton kredimarrëse pranë Iute Credit për të cilën ka kryer 18 transaksione pagesash në shumën totale rreth 146.000 lekë, gjatë periudhës shtator 2010 - dhjetor 2021 (si dhe një pagesë në gusht 2022).
- ✚ **Iute Credit**, me shkresën nr. *** prot., dt. 26.9.2023, konfirmon se shtetasi Alfred Elezi është i regjistruar me anë të 3 kredive për qëllim konsumatorë; përfituar në datë 14.08.2019, në shumën 43.000 lekë; në datë 24.11.2021, në shumën 20.300 lekë; në datë 24.03.2022, në shumën 26.893 lekë. Gjithashtu, shtetasja Julinda Elezi është e regjistruar me anë të 3 kredive për qëllim konsumatorë; përfituar në datë 28.07.2020, në shumën 37.000 lekë; në datë 23.12.2020, në shumën 110.900 lekë; në datë 29.06.2022, në shumën 13.900 lekë.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
- ✚ **Dreitoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën *** prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të Alfred Elezi dhe personave të lidhur me të.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLI I FIGURËS

✚ Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

74 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

- ✚ të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- ✚ verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

75 Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z. Alfred Ismail Elezi me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës².

❖ **Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Ka pasur mbiemrin Elezaj dhe në datën 15.11.2010 e kanë ndryshuar nga “Elezaj” në “Elezi”.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr. ***** datë 19.12.2023

- Ka qenë në hetim lidhur me procedim penal nr. *** të vitit 2006 të regjistruar nga Prokuroria Ushtarake Shkodër për veprën penale të shpërdorimit të armatimit të parashikuar nga neni 62/1 i Kodit Penal Ushtarak, procedim ky i pushuar nga Prokuroria Ushtarake Shkodër më vendim pushimi më datë 30.11.2006.
- Ka qenë i arrestuar vetëm një herë si i dyshuar lidhur me procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit S. V për veprën penale Plagosje e Rëndë, parashikuar nga neni 88 I Kodit Penal. Ky procedim wshtw ndarë dhe ndaj subjektit në vitin 2006 Prokuroria Ushtarake Shkodër ka regjistruar Procedim Penal nr. **, i vitit 2006 për veprën penale “Shpërdorim i Armatimit”. V. Penale parashikuar nga neni 62/1 i Kodit Penal Ushtarak, i pushuar nga kjo prokurori më datë 30.11.2006.
- Ka pasur masë shtërngimi personal “Detyrim Paraqitje” E pushuar.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

76 Në mbështetje të neneve 35- 42 të ligjit nr 12/2018 i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligjzbatuese në

Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. **** prot., datë 15.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi bën me dije se:
 - a. ka ndryshim të gjeneralitetit “mbiemër” nga “Elezaj” në “Elezi” në vitin 2010. Veprim i deklaruar nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaratimit.
 - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

1.1 I pyetur nga relatori i çështjes në emailin e datës 10.07.2024 mbi arsyen e ndryshimit të gjeneraliteteve subjekti i vlerësimit ka deklaruar se:

“Kam bërë ndryshimin e mbiemrit nga Elezaj në ELEZI për shkak se dokumentet e shkollimit tim i kam të gjitha në mbiemrin ELEZI, si diploma e shkollës së mesme dhe diploma e shkollës së lartë.

Sqaroj: Kjo ka ndodhur pasi në gjendjen civile Kukës ku kam lindur ka pas gjithmonë problem dhe një pjesë e madhe e fisit tim kanë mbiemrin ELEZI dhe pjesa tjetër ELEZAJ siç dhe e kam pasur më parë “Si dhe bashkëlidhi dokumentacionin e përmendur në kthim-përgjigjen e tij.

2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “ I kufizuar” nr. **** prot ., datë 09.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi bën me dije se:

- a. Nuk rezulton i dënuar

3. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr.**** prot., datë 18.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alferd Ismail Elezi, si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare **nuk kanë:**

- a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016 “ për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj;
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.);
- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;

- g. Të dhëna në lidhje me ndonje masë debimi nga një shtet i huaj;
 - h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
 - i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore në ngarkim të subjektit të vlerësimit.
4. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Konfidencial” nr.**** prot., datë 11.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi, bën me dije se:
- a. Nuk disponon të dhëna.
5. **Institucion ligjzbatues**, me shkresë “Sekret” me nr. **** prot, e datës 03.10.2023 dhe shkresën “I kufizuar” nr. **** prot., datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:
- a. Për subjektin e vlerësimit në vitin 2006 është referuar material në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës pas arrestimit në flagrancë për veprën penale “Shpërdorim detyre”. Mbi bazën e materialeve të referuara prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr.**** të cilin më pas e ka transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kjo e fundit ka regjistruar procedimin penal nr. **/2006 për veprën penale “*Shpërdorim i armatimit*” sipas nenit 62/1 Kodi Penal Ushtarak. Por në përfundim të hetimeve procedimi penal nr **/2006, në ngarkim të punonjësit të Policisë A.Elezi **është pushuar**.
 - b. Për personat e lidhur me të nuk ka materiale të dhëna ose informacione në ngarkim.
6. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr.**** prot., 14.08.2023 bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi,
- a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.
7. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret” nr **** prot, datë 04.08.2023 bën me dije se:
- a. për subjektin e vlerësimit Alfred Elezi dhe personat e lidhur me të, nuk rezultuan raportime;
8. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën ‘i kufizuar’ nr. **** prot., datë 15.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alfred Ismail Elezi, bën me dije se:
- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli të vlefshme.
 - b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
 - c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
9. **Avokati i Popullit** me shkresën “e paklasifikuar” me nr. **** prot., datë 14.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

10. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “ i kufizuar nr. *** prot., datë 24.11.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alfred Ismail Elezi, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

11. **Institucionet ligjbatuese** me shkresën “sekret” nr.**** prot datë 25.08.2023 nga ku rezulton se në ngarkim të subjektit të vlerësimit ka të dhëna të cilat për të cilat pas verifikimeve të kryera është konstatuar se nuk janë të dhëna të vërtetuara në kuadër të dyshimit të arsyeshem.

77 Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Alfred Elezi nuk është disponuar asnjë ankese nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

78 Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, nr. ****prot., datë 22.07.2023 “Akt ekspertimi” konkludohet se subjekti vlerësimit z. Alfred Elezi.

- Aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

✓ Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Alfred Elezi, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Alfred Elezi

- *Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*

- *Nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

79 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

80 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

81 Subjekti i vlerësimit z. Alfred Elezi, në momentin e dorëzimit të formularit të vlerësimit të aftësisë profesionale datë 09.03.2023, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zëvendës drejtorit për Sigurinë dhe Policimin, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë dhe me pozicion aktual Drejtor i Drejtorisë Vendore Lezhë. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 04.07.2023, subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Zëvendës drejtorit për Sigurinë dhe Policimin, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë”.

✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, është periudha 5-vjeçare (2018-2023). Porcesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHETITIT.

82 Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. **** prot., datë 06.09.2023, raportin e vlerësimit profesional është shprehur me “konkluzion përfundimtar” si më poshtë vijon:

❖ **“Punonjësi i policisë z. Alfred Ismail Elezi është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT.

✚ Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. ****;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues Alfred Ismail Elezi është emëruar Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, me urdhërin nr. ***, datë 25.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Alfred Elezi e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit, mbi nivelin e arsimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

85. Vlerësimi i nivelit të arsimit:

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
DND	Akademia e Policisë	1998	2001	Tiranë	Diplome

- Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, administroi nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. regjistri ****.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzion:

85.1 Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.

❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

86. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

❖ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

1. ka përfunduar me sukses seminarin “Trajnimi i Trajnerëve të Policisë” shtator 2022.
2. ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave në vitin 2017.

Trupa e vlerësimit, pas administrimit të dosjes së personelit, të subjektit konfirmon pjesëmarrjen e subjektit të vlerësimit në trajnime dhe kualifikime e deklaruara si dhe konstaton se trajnimet e kryera nga subjekti i vlerësimit janë të nevojshme dhe në përputhje me funksionin që ushtron.

❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi vlerësimet e punës, së subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

86 Vlerësimet e punës:

Për periudhën e vlerësimit 5 vitet e fundit (2018-2023) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për subjektin janë pasqyruar vlerësimet e punës si më poshtë vijon:

- Për vitin 2018 me rezultat 28 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2019 me rezultat 28 pikë (shumë mirë).
- Për vitin 2020 me rezultat 28 pikë (shumë mirë).
- Për vitin 2022 me rezultat 98 pikë (shumë mirë).

(Në vlerësimin e mësipërm vlen të theksohet se për periudhën 2018-2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishtë 28 pikë, ndërsa në vitin 2022 vlerësimi maksimal është 100 pikë)

42.1 Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës objekt vlerësimi subjekti, është vlerësuar maksimalisht “shumë mirë”.

❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit, mbi masat disiplinore të subjektit të vlerësimit, në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

87. Masat disiplinore:

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5 - vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit 2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

87.1 Trupa e vlerësimit konstaton se, subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.

- ❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

88. Ecuria në karrierë.

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Alfred Elezi a ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 21 vitesh e 11 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5 - vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

- **Gradën “Drejtues”**

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr urdhri	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar		Nr. ** datë 18.06.2008	11.06.2008	31.07.2022
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr. *** datë 28.07.2022	01.08.2022	

88.1 Në zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, referuar fitimit të gradës policore nga “Kryekomisar”, në “Drejtues” me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. *** datë 01.08.2022 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, trupa e vlerësimit konstaton se koha e fitimit të gradës është e vitit 2022, brenda periudhës 5 – vjeçare, objekt vlerësimi. Grada “Drejtues” është përfutur në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, të cilat normohen në ligjin dhe aktet nënligjore të organizimit dhe funksionimit të Policisë së Shtetit.

- **Funksioni “Drejtor i Drejtorisë Vendore Lezhë”**

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
01.08.2023	Aktualisht	Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	Drejtor
18.04.2022	31.07.2023	Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	Zv/Drejtor
17.11.2021	17.04.2022	Drejtoria Përgjithshme e Policisë	Shef Sektori
01.05.2019	16.11.2021	Drejtoria Përgjithshme e Policisë	Shef Sektori
27.07.2018	30.04.2019	Drejtoria Vendore Shkodër	Shef Sektori
05.07.2018	26.07.2018	Drejtoria Vendore Shkodër	Shef Sektori
01.06.2017	04.07.2018	Drejtoria Vendore Shkodër	Shef Sektori

88.2 Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit, ka mbajtur funksionin “Drejtor” në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon.

88.3 **Trupa e vlerësimit** në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit, z. Alfred Elezi arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi pjesëmarrjen në konferenca shkencore, workshope seminare, të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

89. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore, ëorkshope apo seminare.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Alfred Elezi;

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 25.07.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 29.08.2024, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Alfred Ismail Elezi, në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit z. Alfred Ismail Elezi, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 29.08.2024, në Tiranë.

KRYESUES

ENTON RADOVANI

RELATOR

KLEADA MERSINLLARI

ANËTAR

EDONA DUSHAJ